

E drejta dhe detyra e mësimit të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore



Mësimi i norvegjishtes dhe i njohurive shoqërore për imigrantë është përcaktuar me ligj prej 1 shtatorit 2005. Mësimet do t'a përforcojnë mundësinë e imigrantëve për pjesëmarrje aktive në jetën e punës dhe të shoqërisë.

Njohuria e gjuhës norvegjishtja është e nevojshme për të kuptuar dhe për t'u marrë vesh, për të gjetur punë, për arsimimin më tutjedhe për pjesëmarrjen në jetën e shoqërisë.

Imigrantët të rritur me leje qëndrimi që është bazë për vendosje kanë të drejtën dhe detyrimin që të marrin 300 orë mësimi të gjuhës norvegjeze dhe të njohurive shoqërore. Përgjegjësi për mësimet është komuna. Për t'u vendosur ose për të fituar shtetësinë norvegjeze imigrantët duhet të kryejnë 300 orë mësimi, ose duhet të dokumentojnë që kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës norvegjeze ose të gjuhës lapone. Kjo vlen për personat që kanë marrë leje qëndrimi pas 1. shtatorit 2005. Për personat që kanë marrë leje qëndrimi para 1. shtatorit 2005, vlen një zgjidhje kalimtare.

Parimet kryesore në lidhje me të drejtën dhe detyrimin e mësimit të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore

- Imigrantët kanë të drejtën dhe obligimin që të marrin 250 orë mësimi të gjuhës norvegjeze dhe 50 orë të njohurive shoqërore në një gjuhë që ata kuptojnë.
- Komuna duhet të rregullojë dhënien e mësimëve.
- Çdo person duhet të kërkojë vet nga komuna që t'i jepen mësimet. Mësimet duhet të fillohen sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se 3 muaj pasi personi ka bërë kërkesë.
- Vendimi në lidhje me mësimin mirret nga komuna.
- Imigrantët duhet të marrin 300 orë mësimi brenda 3 viteve.
- 300 orë mësimi të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore janë kusht paraprak për marrjen e lejes së vendosjes në shtetin dhe, më vonë, për fitimin e shtetësisë norvegjeze.
- Imigrantë që mund të dokumentojnë që kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës norvegjeze ose të gjuhës lapone mund të lirohen nga obligimi i marrjes së 300 orëve të mësimit.
- Në qoftë se imigrantët kanë nevojë për më shumë mësim, mund të marrin deri më 2700 orë ekstra. Në ndërkohë, obligimi vlen vetëm për kryerjen e 300 orëve. Komuna mund të kërkojë që imigranti t'i nënshtrohet disa testeve për të shqyrtuar nevojën e mësimëve përsipër 300 orëve.
- Tërë mësimi prej 3000 orë duhet të kryhet brenda 5 viteve.

- Oferta e mësimave deri më 3000 orë do t'i përshtatet përgaditjes shkollore dhe parakushteve të secilit person. Për këtë, të gjithë që marrin pjesë në arsimimin duhet të kenë një plan individual mësimor.
- Si rregull, e drejta e mësimit të norvegjishtes falas do të ndërprehet në qoftë se mësimi nuk është përfunduar brenda afatit të caktuar. Persona që kanë patur pengesa në pjesëmarrjen në mësim mund të kërkojnë fitimin e të drejtës dhe të detyrimit të mësimave sërish në raste kur afati ka skaduar.

Kush ka të drejtë dhe detyrim që të mësojë norvegjishte dhe njohuri shoqërore?

Grupet e përmendura më poshtë kanë të drejtën dhe obligimin e mësimit të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore:

- Persona me status azilit
- Refugjatë të transferuar
- Persona me leje qëndrimi për shkaqe humanitare
- Persona me mbrojtje kolektive
- Persona të ribashkuar me ata të përmendur më lartë
- Persona të ribashkuar me shtetas norvegjez ose nordik
- Persona të ribashkuar me ata që kanë leje vendosjeje

E drejta dhe detyrimi do të thotë që këta grupe kanë detyrën që të realizojnë mësim të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore për 300 orë, dhe kanë të drejtën që këtë mësim t'a marrin falas.

E drejta dhe detyra e pjesëmarrjes vlen vetëm për persona në moshën 16-55 vjeç. Personat e moshës 55-67 vjet kanë të drejtën por jo obligimin që të marrin pjesë në mësimin.

Grupet e përmendur këtu më poshtë nuk kanë të drejtën e mësimit falas, por kanë detyrën e realizimit të 300 orëve të mësimit të norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore:

- Imigrantët e punës që vijnë nga jashtë zonës së BEE-së ose të EFTA-s
- Persona që vijnë në shtetin në bazë të ribashkimit familjar me imigrantë pune nga zonat jashtë BEE-së dhe të EFTA-s

Vetëm persona të moshës 16 – 55 vjeç kanë obligimin e pjesëmarrjes në mësimet.

Kush nuk ka as të drejtë dhe as detyrim që të marrë pjesë në mësimin e norvegjishtes dhe të njohurive shoqërore?

Këta grupe nuk kanë të drejtë dhe obligim që të mësojnë ngjuhën norvegjeze:

- Studentët
- Punëtorët au pair dhe tjerë me leje qëndrimi të përkohshme
- Shtetasit nordikë
- Persona me të drejtën e qëndrimit sipas rregullave të BEE-së dhe të EFTA-s

Kjo do të thotë që komuna nuk është përgjegjëse për të rregulluar mësimin e norvegjishtes për grupet në fjalë.

Zgjidhje kalimtare për personat që kanë marrë leje qëndrimi para 1. shtatorit 2005

Persona që kanë marrë leje qëndrimi më herët se 1. shtatori 2005 dhe që nuk kanë patur mësim të norvegjishtes, kanë edhe tash mundësi që të marrin mësim të norvegjishtes. Por ata nuk bijnë nën të drejtën dhe obligimin e mësimit të norvegjishtes, kështu që nuk janë të detyruar të kenë 300 orë mësimi për të marrë lejen e vendosjes. Për këta vlen një zgjidhje kalimtare. Zgjidhja kalimtare vlen për 5 vite prej 1. shtatorit 2005.

Kërkesa për shtetësi pas 1. shtatorit 2008

Gjithkush që do të kërkojë shtetësi norvegjeze pas 1. shtatorit 2008 duhet të dokumentojë që ka kryer 300 orët e mësimit të norvegjishtes ose duhet të dokumentojë që ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës norvegjeze ose të gjuhës lapone. Kjo vlen për të gjithë, pavarësisht se kur ka marrë leje qëndrimi.

Informacione plotësuese

Mund të merrni informacione plotësuese duke kontaktuar komunën. Entet e komunës ku mund të drejtoheni mund të jenë:

- Arsimimi i të rriturve
- Zyra e Shërbimeve Publike
- Zyra e Refugjatëve
- Zyra e Programit Hyrës
- Zyra për Çështje Ekonomike Sociale

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.